



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut*

*Nënkomisioni për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 22.06.2020, ora 10:00

**Drejtojnë mbledhjen:**

**Vasilika Hysi dhe Eglantina Gjermani**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit të punës së Nënkomisionit për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, për periudhën 22 qershor- 30 korrik 2020.
2. Miratimi i kalendarit të punës së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, për periudhën 22 qershor- 30 korrik 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të datës 2 tetor 2019, të mbledhjes së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.
4. Prezantimi dhe diskutimi i shkresës së UN Women për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në zgjedhje.

**Marrin pjesë:**

Vasilika Hysi, Alban Zeneli, Eglantina Gjermani, Xhemal Qefalia, Aurora Mara dhe Klotilda Bushka

**Mungojnë:**

Jurgis Çyrbja dhe adriatik Alimadhi

**Të ftuar:**

Aurela Anastasi - eksperte pranë UN Women

Irida Agolli - eksperte pranë UN Women

Estela Bulku - përfaqësuese e UN Women

## **HAPET MBLEDHJA**

**Vasilika Hysi** - Përshëndetje, të nderuar kolegë dhe kolege!

Sot zhvillojmë mbledhjen e përbashkët të dy nënkomisoneve, të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Nënkomisionit për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas.

Rendi ditës dhe materialet për këtë mbledhje ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike. Ndërkohë, dua t'ju rikujtoj që janë hartuar dy kalendarët e punës së nënkomisoneve për periudhën 22 qershor-31 korrik. Duke qenë se mbledhjen do ta bashkëdrejtoj me kolegen Gjermani, në pjesën e parë të mbledhjes do të vijoj unë dhe në pjesën e dytë do të vijojë kolegja Gjermani.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punës së Nënkomisionit për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas për periudhën 22 qershor-31 korrik. Për këtë pikë të rendit të ditës voton vetëm Nënkomisioni për Barazinë Gjinore. Kush është dakord të ngrejë dorën. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punës së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut për periudhën 22 qershor- 30 korrik 2020. Për këtë pikë të rendit të ditës do të votojnë vetëm anëtarët e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Pika e tretë është miratimi i procesverbalit të datës 2 tetor 2019 të mbledhjes së Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, ku ne kemi diskutuar për projektraportin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe autorizimin që kemi dhënë për t'iu nënshtruar konsultimit publik.

Të nderuar kryetarë të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, dua t'ju bëj me dije se sekretaria e nënkomisionit draft-projektraportin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të hartuar, e nisi për konsultim publik dhe pas përfundimit të periudhës së këtij konsultimi kanë ardhur disa mendime dhe sugjerime, por jo ato që ne kemi pritur. Për rrjedhojë, për shkak edhe të situatës së shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit dhe të periudhës së COVID-it, ne nuk kemi mundur të

mblihdemi dhe ta diskutojmë projektraportin, por ne nuk mund të presim më lidhur me procesin e konsultimit publik. Nëse organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë të veçantë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, kanë materiale, informacione, raporte ose çështje, që kërkojnë të adresojnë, të cilat lidhen me periudhën para dërgimit të raportit, ose me periudhën nga data 2 tetor, kur është përcjellë raporti për konsultim publik dhe sot, janë të mirëpritur, pasi në kalendarin e sapomiratur miratimi i këtij raporti është lënë të zhvillohet në mbledhjen e datës 20 korrik, e cila do të jetë një mbledhje e përbashkët me Nënkomisionin për Organet e Vetëqeverisjes Vendore. Prandaj bëj përsëri një ftesë publike, meqenëse kemi edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, për t'i ftuar edhe një herë dhe për të paraqitur mendimet e sugjerimet që mund të kenë për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe angazhimin që kërkojnë nga ana e Kuvendit të Shqipërisë.

Pika e fundit e rendit të ditës është prezantimi dhe diskutimi i një shkrese, që ka ardhur nga UN Women për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare për parandalimin e dhunës me bazë në zgjedhje.

Ju të gjithë, të nderuar kolegë, keni marrë në adresat tuaja personale një letër, e cila ka ardhur në adresën time, si zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë, i ka ardhur zonjës Eglantina Gjermani, si kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, njëkohësisht, dy bashkëkryetarëve, zotit Damian Gjijnuri dhe zonjës Rudina Hajdari, në kuadër të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore. Në konsultim me njëra-tjetrën, edhe unë, edhe zonja Gjermani, menduam që këto rekomandime dhe sugjerime të organizatave dhe të UN-it të prezantohen drejtpërsëdrejti nga përfaqësuesit e UN-it. Ju keni marrë një material në Power Point, të cilin e ka sjellë kolegja Gjermani, “Parandalimi i dhunës ndaj grave në zgjedhje”, i cili është përgatitur nga UN Women, por, njëkohësisht, edhe një udhëzues, i përgatitur nga UN Women.

Unë dua t'ia kaloj vijimin e drejtimit të mbledhjes zonjës Gjermani, duke i falënderuar përfaqësuesit e UN Women për të gjitha problematikat që kanë adresuar, por edhe për materialet që na kanë vënë në dispozicion!

Faleminderit!

**Eglantina Gjermani**- Shumë faleminderit, kolege!

Përshëndetje të gjithëve!

Shume faleminderit që jeni me ne! Përveç anëtarëve të dy nënkomisioneve, të të Drejtave të Njeriut dhe të Barazisë Gjinore, kemi edhe koleget nga Aleanca e Grave Deputete, të cilat dua t'i falënderoj që janë të pranishme në këtë mbledhje të rëndësishme!

Menjëherë do të fillojmë më prezantimin nga përfaqësuesit e ftuar, zonja Estela Bulku, e cila është përfaqësuese e UN Women, Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Gratë në Shqipëri, zonja Aurela Anastasi, profesoresha e nderuar, e cila është eksperte dhe do të na thotë më në detaje rekomandimet konkrete për sa i përket mundësisë së përfshirjes së tyre në Kodin Zgjedhor, dhe zonja Irida Agolli, e cila është eksperte pranë UN Women.

Fjala për ju, zonja Bulku.

**Estela Bulku**- Përshëndetje!

E nderuar zonja Hysi,

E nderuar zonja Gjermani,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju falënderoj në emër të zyrës së UN Women për ftesën në këtë takim të përbashkët të dy nënkomisioneve!

Puna me dy nënkomisionet është një ndër aspektet e punës sonë në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së mirëkuptimit që UN Women ka nënshkruar me Kuvendin, por edhe në zbatim të të gjithë legjislacionit, që ka të bëjë me barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës ndaj grave.

UN Women, në nivel global, ka shqyrtuar çështjen e dhunës ndaj grave në zgjedhje dhe në politikë. Ky është një fenomen që ndodh në mbarë botën, por që njihet pak, të cilit i është dhënë rëndësi vitet e fundit nga organizatat e Kombeve të Bashkuara. Kjo për t'u sjellë në vëmendje shteteve anëtare dhe aktorëve të ndryshëm të shoqërisë këtë fenomen, i cili cenon një nga të drejtat thelbësore të grave, që është e drejta politike, të cilën gratë e gëzojnë. Dhuna që ushtrohet ndaj tyre, e cila ndodh në forma të ndryshme, e cenon rëndë këtë të drejtë dhe pengon jo vetëm gratë aspirante dhe gratë që janë në detyra politike, por edhe gratë e tjera, që dëshirojnë të angazhohen në politikë dhe vendimmarrje.

Fillesa e gjithë kësaj pune ka të bëjë me një udhëzues programimi, të cilin UNDP-ja së bashku me UN Women e kanë hartuar në vitin 2017 dhe që me punën e mëtejshme është pasuruar me shembuj konkretë dhe me të dhëna, që janë mundur të mblidhen në nivel botëror për këtë fenomen.

Vështirësia që është hasur për ta sjellë këtë në vëmendje është se nuk ka pasur një përkufizim të pranuar për fenomenin e dhunës ndaj grave në zgjedhjen në politikë. Pra, ekziston si çështje vetëm nga anekdotat apo nga historitë, që mund të jenë sjellë në vëmendje të publikut, dhe për këtë shkak UN Women është munduar që në këtë udhëzues programi të sjellë një përkufizim për fenomenin e dhunës ndaj grave në zgjedhje, të cilin unë dua ta lexoj: “Dhuna ndaj grave në politikë... (*shkëputje interneti*) kanosje e dhunës me bazë gjinore, që kryhet në hapësira publike ose private dhe që rezulton në dëmtim fizik, psikologjik, seksual apo vuajtje të grave dhe që i pengon ato të ushtrojnë dhe të realizojnë të drejtat e tyre politike, përfshirë edhe të drejtën për të votuar, për t’u zgjedhur, të drejtën për të ruajtur fshehtësinë e votës dhe për të zhvilluar fushata zgjedhore të lira dhe të drejtën për t’u grumbulluar dhe organizuar, si dhe të drejtën për të gëzuar lirinë e shprehjes dhe të opinionit”. Kjo dhunë mund të ushtrohet nga anëtarët e familjes, nga anëtarë të komunitetit, ose nga shteti. Dhuna ndaj grave në zgjedhje është një formë e dhunës ndaj grave, që synon të ndikojë në realizimin e të drejtave politike të grave në kontekstin zgjedhor.

Cilat janë disa nga format e dhunës ndaj grave në zgjedhje dhe në politikë? Është konkluduar, edhe nga studimet e fundit që janë bërë nga Unioni Ndërkombëtar Parlamentar, nga Këshilli i Europës dhe nga studime të tjera në nivel kombëtar në vende të ndryshme, që forma më të shprehura të kësaj dhune janë: dhuna psikologjike, e cila prek më së shumti gratë në procese zgjedhore dhe në politikë, dhuna fizike, dhuna seksuale, por edhe dhuna ekonomike.

Në udhëzuesin e programit do t’i gjeni të detajuara të gjitha këto forma, se si ato shfaqen dhe kush gra të angazhuara në politikë dhe në vendimmarrje preken më së shumti nga këto forma në faza të ndryshme të proceseve zgjedhore apo edhe të ushtrimit të detyrës.

Kush preket nga dhuna ndaj grave në politikë dhe në zgjedhje? Kryesisht janë gratë votuese, gratë kandidate dhe aspirante për të kandiduar, mbështetëset politike dhe ato që mbështesin fushatën e grave kandidate, zyrtare të administrimit të zgjedhjeve dhe të qendrave të votimit, si dhe gratë e zgjedhura që ushtrojnë një detyrë në institucione të ndryshme.

Cilët janë autorët që ushtrojnë dhunë ndaj grave në zgjedhjet në politikë?! Ndahen në 3 kategori kryesore: aktorë politikë, ku mund të përmenden kryetarë të partive politike, kandidatë burra në zgjedhje, anëtarë të ndryshëm të partive politike, mbështetës politikë, stafe të fushatës apo militantë të ndryshëm, aktorë shoqërorë, që janë zgjedhësit, anëtarët e familjes, partnerët intimë, bashkëshortët, anëtarë të komunitetit apo të grupeve të ndryshme të interesit, udhëheqës fetare, medie më së shumti, punëdhënës, kolegë apo elementë të krimi, grupe të ndryshme të rinjsh

(nga sa është studiuar ky fenomen), si dhe aktorë shtetëror, ku futen individët që përfaqësojnë institucione, pra aktorë të sigurisë së shtetit, policia, Forcat e Armatosura, institucionet qeveritare nga pushteti ekzekutiv, gjyqësor apo legjislativ, komisionerët zgjedhorë, si dhe grupe joshtetërore, domethënë gati shtetërore, në ato shtete, ku nuk funksionojnë institucionet e zgjedhura.

Gjithsesi, përveçse sjell në vëmendje të gjitha këto forma të dhunës, pra kush e pëson dhe kush e ushtron atë, sjell në vëmendje të të gjithë aktorëve dhe disa masa apo iniciativa që mund të ndërmerren që mendoj se do të japin efekt në adresimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Unë po ndalem te një nga këto masa, e cila ka të bëjë me reformat legjislative dhe reformat në politika në nivel kombëtar. Nga udhëzuesi sugjerohet që në ndërmarrjen e këtyre reformave të përdoret kuadri normativ ndërkombëtar, siç është konventa CEDAW apo konventa të tjera, të cilat kanë lidhje me ushtrimin e të drejtave politike të grave, reforma ligjore është konteksti, në të cilin po e sjellim në vëmendje, pra, me rastin e diskutimeve për ndryshime në Kodin Zgjedhor; zbatimin i mirë i legjislacionit ekzistues, ndërmarrja e protokolleve për organet e administrimit të zgjedhjeve, për parandalimin e fenomenit dhe zbatimin e këtyre protokolleve apo dhe forma të tjera, siç mund të jenë kode të sjelljes të miratuara me ligj.

Në kuadër të reformës ligjore, udhëzuesi sugjeron tri aspekte legjislative që mund të ndërmerren:

Së pari, është hartimi, ndoshta, miratimi i një ligji të posaçëm për dhunën ndaj grave në zgjedhje në politikë; dhe i vetmi rast në botë është Bolivia.

Së dyti, adresimi i kësaj forme të dhunës ndaj grave në legjislacionin ekzistues kombëtar për dhunën ndaj grave.

Së treti, është zgjerimi dhe integrimi i këtij fenomeni në Kodin Zgjedhor kombëtar apo edhe në Kodin Penal. Kjo është hapësira që ne menduam t'ia propozojmë Kuvendit të Shqipërisë, si një nga format e rekomanduara dhe më realiste për t'u adresuar në legjislacionin shqiptar.

Nuk dua të ndalem te propozime konkrete, pasi do t'ia lë fjalën ekspertes UN *Women*, zonjës Aurela Anastasi, e cila na ndihmoi për ta shqyrtuar me imtësi kuadrin ligjor shqiptar, atë ndërkombëtar dhe udhëzuesin, për të propozuar rekomandime konkrete, në kuadër të reformës zgjedhore dhe të Kodit Zgjedhor.

Faleminderit për vëmendjen!

Dua t'ia kaloj fjalën ekspertes sonë për të vijuar me rekomandime konkrete.

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, zonja Bulku!

Faleminderit, *UN Women*, Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Gratë, që, në fakt, gjithmonë ka qenë pranë nesh dhe, ashtu siç e thatë edhe ju, ka bashkëpunuar fort në kuadrin e përmirësimit të ligjeve, sidomos në kuadrin e barazisë gjinore, përveç faktit që ka edhe një marrëveshje me parlamentin shqiptar. I vlerësoj rekomandimet që sillni dhe prezantimet që ju bëtë. Ndërkohë që e marrim në shqyrtim sot, sepse vërtet ne si parlament në dhjetor të vitit 2017 kemi miratuar një rezolutë në mënyrë unanime kundër dhunës ndaj grave, pra të të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

Më vjen mirë që, krahas dhunës në jetën e përditshme, po trajtojmë një aspekt të veçantë të saj që është folur pak ose aspak, për të cilën nuk ka studime të provuara, por ka vrojtime. Ndërkohë, në udhëzuesin që ju keni dërguar një nga studimet e bëra në nivel botëror, 81% e grave të intervistuar, që ishin në politikë dhe kishin marrë pjesë në zgjedhje, dëshmonin se kishin qenë pre e formave të ndryshme të dhunës. Kështu që mendoj se është një çështje, e cila meriton vëmendje. Patjetër e vlerësoj shumë faktin që, në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare që shteti shqiptar ka, sigurisht, kemi përgjegjësinë dhe angazhimin për ta dresuar edhe këtë problem.

Do t'ia jap fjalën profesoreshë Aurelës që të prezantojë rekomandimet dhe ristrukturimet, më pas do të vijojmë me pyetje dhe diskutime nga të gjithë kolegët.

Profesoreshë, fjala për ju.

**Aurela Anastasi** –Përshëndetje! Faleminderit për ftesën!

E nderuara zonja Nënkryetare e Kuvendit,

E nderuar zonja Gjermani,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Unë dua të ndalem praktikisht në disa propozime, që lidhen pikërisht me adresimin e kësaj çështjeje në të gjithë paketën e propozimeve të ardhura nga shoqëria civile dhe nga organizatat ndërkombëtare për Kodin Zgjedhor. Pra, ju e keni në materiale paketën e propozimeve. Doja vetëm të vija në dukje se aty janë një sërë propozimesh, që lidhen me përmirësimet e dispozitat e Kodit Zgjedhor edhe për çështje të tjera të rritjes së pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje dhe në organet e zgjedhura politike, por ne do të ndalemi vetëm në ato që i përkasin çështjes së parandalimit, të ndalimit dhe të mbrojtjes së gruas në politikë dhe në zgjedhje nga dhuna. Format e dhunës janë të ndryshme, sidoqoftë ne jemi përpjekur që të japim propozime për përmirësime legislative brenda kuadrit ekzistues ligjor. Këto propozime përfshijnë edhe Kodin Zgjedhor. Janë vetëm një aspekt i

propozimeve që paraqiten në Kodin Zgjedhor dhe kudo të mëshojmë ne sot, pasi në një raport të përgatitur nga *UN Women* ne kemi paraqitur dhe propozime të tjera për përmirësimin e kuadrit ligjor në vëmendje të parandalimit dhe të ndalimit të dhunës ndaj grave në politikë dhe në zgjedhje, por, për mendimin tim, ato nuk janë objekt i diskutimit të sotëm.

Në qoftë se më lejohet ta ndaj përmbajtjen me ju, nuk e di nëse duhet të nxjerrë disa *slide*, sepse të them të drejtën... Ju nuk keni leje- më thotë. Nëse do të më lejoni, do të ishte mirë, sepse vërtet ju e keni në materialin me shkrim përmbajtjen e neneve që janë propozuar konkretisht, por do të na ndihmonte një ndarje këtu me *slide*.

Faleminderit, Ervis! Unë do të përpiqem ta ndaj! Dua të them se parashikimi i dispozitave edhe në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna grave në zgjedhje është mjaft i rëndësishëm për të realizuar atë sistem të kuotës gjinore, që ne e kemi krijuar në legjislacion tashmë. Si t'i marrim si dispozita të pavarura, edhe po t'i kuptojmë si pjesë atij sistemi, mendoj se këto dispozita që ne propozojmë në paketë si shoqëri civile dhe si organizatë ndërkombëtare janë mjaft të rëndësishme.

Më falni, besoj se ju ka ardhur?

**Vasilika Hysi** – Po, është në rregull.

**Aurela Anastasi** –Më falni, por nuk kisha punuar ndonjëherë me këtë program. Faleminderit që më bëtë edhe mua ta përdor këtë program për herë të parë! Unë nuk po zgjatëm në aspekte të tjera, të cilat plotësojnë ato çka zonja Estela parashtroi para jush në lidhje me standardet ndërkombëtare. Duhet të themi që nuk kemi standarde të adresuara konkretisht, por ka një përpjekje prej dy vjetësh për të legjitimuar ndërhyrjen në legjislacionet e vendeve për të parandaluar dhe për të ndaluar dhunën ndaj grave në zgjedhje dhe në politikë, mbështetur në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut, në Konventën për të Drejtat Politike të Grave, në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) e të tjera, por kemi edhe përvojën e shteteve. Të mos harrojmë përvojën në Shtetet e Bashkuara, ku në 40 vjet në studime janë arritur konkluzione të rëndësishme, fjala vjen:“Gratë kandidate vazhdimisht trajtohen nga media më tepër për pamjen, personalitetin dhe familjen e tyre dhe më pak trajtohen për çështje të vlerave të tyre, sikurse trajtohen zakonisht meshkujt. Këto diferenca, që shkojnë edhe përtej gjuhës tipike seksiste, mund të cenojnë besueshmërinë ndaj një gruaje kandidate”. Madje, kjo përvojë e Shteteve të Bashkuara është sjellë qëllimisht para jush për të treguar se, pavarësisht se format e dhunës e impaktojnë shumë legjislacionin penal, sepse ka edhe forma dhune, siç është



gjuha e urrejtjes, gjuha seksiste fyese, gjuha seksiste poshtëruese, mund të adresohen administrativisht dhe konkretisht nga Kodi Zgjedhor.

Në Moldavi, për shembull, kandidatja për postin e Presidentit të Republikës në vitin 2016, Maja Sanduz u atakua nga një drejtues i kishës ortodokse të Moldavisë, me qëllim vënien në dyshim të besueshmërisë së saj morale. Ku qëndronte problemi?! Ai hodhi dyshime për moralin e kandidatës, pasi, edhe pse ishte 44 vjeç, ajo nuk ishte as e martuar dhe as nënë.

Të mos harrojmë edhe studimet e ndërmarra nga Unioni Parlamentar Ndërkombëtar, që i përmendi Estela këtu, ku 81,8% e grave të pyetura kanë pësuar dhunë psikologjike; janë të gjitha gra që synojnë karrierën; 44,4% janë kërcënuar me vdekje, me dhunë seksuale, me rrahje ose me pengmarrje; 25,5% e grave kanë pohuar se kanë pësuar dhunë fizike brenda parlamentit; 46,7% e grave ishin të frikësuara për sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre. Pra, është fjala për gra në karrierë, gra aspirante, kandidatë që duan të aplikojnë për poste të ndryshme politike. Ndërkohë, në Shqipëri, për fat të keq, nuk e kemi të adresuar në ndonjë dokument këtë çështje. Me sa duket, këto vitet e fundit po del në pah si çështje. Kemi, bie fjala, mjaft raporte të monitorimit të zgjedhjeve nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare. Këtu në *slide* kam mbajtur parasysht Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe OSBE-ODIHR-in. Në të dyja rastet evidentohen probleme të dhunës në përgjithësi, por nuk është analizuar konkretisht shkaku gjinor. Kjo i bën këto që të mos klasifikohen si studime, që lidhen me çështjen që ne adresojmë dhe na bën të mendojmë që legjislacioni duhet ta adresojë si çështje, përndryshe, nuk mund të bëhet çështje që të parandalohet, të ndalohet apo edhe të diskutohet. Pra, në radhë të parë, ne duhet ta ngremë këtë si çështje. Për shembull, në raportin e fundit të OSBE-ODIHR-it thuhet: “Gratë kandidatë morën pak vëmendje nga media. Kanalet televizive publike dhe private, të monitoruara nga OSBE-ODIHR-i, u kushtuan grave 13% të pasqyrimin në fushatë”. Pra, është një diskriminim. Ndaj OSBE-ODIHR-i rekomandon: “Çdo rast dhe pretendim për presion duhet të hetohet dhe të ndiqet në mënyrë tërësore dhe të efektshme nga autoritetet përkatëse. Të gjitha këto raste, duke përfshirë rezultatin e tyre, duhet të raportohen publikisht”.

Vijmë te dokumenti, i cili, sikurse ju e keni në tavolinat tuaja të punës, ka disa rubrika. Rubrika e përfshirjes së parimeve të barazisë gjinore në reformën zgjedhore parashtron disa aspekte, për shembull, Kodi Zgjedhor duhet të përkufizojë dhe të adresojë dhunën me bazë gjinore në zgjedhje dhe të sigurojë që protokollat dhe rregulloret e KQZ-së të ndalojnë dhe të parandalojnë dhunën ndaj grave në zgjedhje dhe përdorimin e gjuhës së urrejtjes në përgjithësi. Kodi Zgjedhor

duhet të sigurojë që dhuna ndaj grave në zgjedhje të monitorohet dhe të raportohet tek autoritetet, si pjesë e procesit të monitorimit të zgjedhje dhe duhet të përfshijë sanksione për shkeljen e këtyre dispozitave. Konkretisht, s të gjitha këto janë politikat që ndiqen duhet të gjejnë një mënyrë në kuadrin e teknikës legjislative që të përfshihen në përmbajtjen e Kodit.

Për shembull, unë mendoj se i përfshin rekomandimi i këtij dokumenti, i kësaj pakete, që të kemi një dispozitë të ngjashme me këtë: “Kodi Zgjedhor respekton parimin e barazisë gjinore dhe u garanton burrave dhe grave mbrojtje të barabartë për pjesëmarrjen në zgjedhje”. Kjo duhet të jetë e përfshirë në dispozitat e përgjithshme.

Në dokumentin e propozimeve kemi edhe propozime në nivel politikash, ku thuhet shprehimisht se ligji duhet të japë përcaktimin e dhunës me bazë gjinore, format që ajo merr, si dhe mekanizmat administrativë dhe sanksionet që e adresojnë atë gjatë zgjedhjeve, me qëllim parandalimin dhe luftimin e saj.

Propozime në nivel teknik ka, gjithashtu, si: parandalimi dhe lufta e dhunës ndaj grave në zgjedhje përmes dispozitave në Kodin Zgjedhor të përcaktojnë detyrimin ndaj organeve zgjedhore dhe subjekteve zgjedhore, me qëllim ndalimin e dhunës, raportimin e saj dhe vendosjen e sanksioneve efektive.

Tani dua ta përqendrojmë vëmendjen te propozimet konkrete që kemi bërë, me qëllim që të ndihmojmë sa më shumë në atë që ju do të adoptoni në ligj, pra në përmbajtjen e ligjit. Njëra mundësi është të shtojmë në nenin 21, të mbajmë parasysht që jemi nisur në kuadrin e ligjit ekzistues. Në qoftë se do të ketë një riorganizim të plotë të Kodit Zgjedhor, le të themi, një shfuqizim të kodit ekzistues dhe një kod të ri, atëherë mund të kemi më shumë hapësira. Por ne jemi përpjekur të shfrytëzojmë hapësirat që kemi. Kështu, për shembull, në nenin 21 paketa propozon që pas pikës 20 të shtohet pika 20/1 me këtë përmbajtje: “Ndalohen subjektet zgjedhore, kandidatët dhe përkrahësit e partive politike; kandidatët e pavarur dhe përkrahësit e tyre; punonjësit e administratës zgjedhore dhe personat e tjerë që punojnë gjatë procesit zgjedhor të botojnë, të postojnë dhe të shpërndajnë artikuj, njoftime, programe dhe/ose materiale të tjera të fushatës zgjedhore, në të cilat gratë ose burrat fyhen dhe/ose poshtërohen për shkak të gjinisë ose për shkaqe të tjera, si dhe urdhëron të gjitha subjektet zgjedhore, institucionet apo mediet që t’i heqin ato”. Kjo është faza e parë. Pra, përcakton kundërvajtjen administrative, që është një gjuhë seksiste fyese ose poshtëruese dhe, siç e shikojmë, është dhënë edhe karakteri më i përgjithshëm, pra jo vetëm gjinore, por edhe për shkaqe të tjera, si dhe jep zgjedhjen e parë që është në kuadrin

e heqjes së këtyre publikimeve, e fshirjes së këtyre publikimeve. Por kjo nuk do të thotë që mund të mos ketë sanksione të tjera, siç parashikohen për rastet e kundërvajtjeve të tjera në Kod.

Më tej, ne kemi propozuar në paketë edhe një nen tjetër, të cilit i kemi dhënë natyrë të përgjithshme. Këtë e kemi bërë, me qëllim që të jetë sa më e pranueshme, sepse ka diçka: është e mundur që ata, të cilët hartojnë Kodin nga pikëpamja e teknikës legjislative të ngrenë pretendimin që, krahas shkakut gjinor, raste të gjuhës së urrejtjes ka edhe për shkaqe të tjera ose çdo shkak tjetër. Kjo është e përcaktuar edhe nga ligji ynë “Për mosdiskriminimin”. Megjithatë, ne duam të bëjmë një vërejtje në këtë rast. Ne duam që të gjitha shkaqet të parashikohen, por shkak gjinor të vihet në dukje, pasi është i mprehtë dhe, duke u vënë në dukje, arrin të raportohet. Në qoftë se ne nuk e kemi në gjuhën e ligjit, nuk arrijmë ta raportojmë atë.

Sidoqoftë, te pika 20 shtohet pika 20/2: “Ndalohen kandidatët dhe përkrahësit e partive politike; kandidatët e pavarur dhe përkrahësit e tyre; punonjësit e administratës zgjedhore dhe personat e tjerë që punojnë gjatë procesit zgjedhor të përdorin gjuhë që mund të provokojë ose të nxisë dhunë, të përhapin urrejtje apo të publikojnë ose të përdorin fotografi, simbole, regjistrime audio dhe video, mesazhe (sms), komunikime në internet apo çfarëdo materiali tjetër që mund të ketë një efekt të tillë, si dhe urdhëron të gjitha subjektet elektorale, institucionet dhe mediet t’i heqin ato”. Pra, ne do ta preferonim për shkak të gjinisë, në qoftë se do të kishim mundësi teknikët legjislativë ta realizojnë këtë. Unë e thashë arsyeën pse duhet përmendur edhe shkak gjinor në i japim prioritet. Ne dhunën ndaj grave në zgjedhje e kemi prioritet në kuadër të plotësimit të të gjithë paketës sonë për pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrje, për të cilën parlamenti ynë ka prej vitit 2010 që punon.

Një shtesë tjetër e kemi menduar në pikën 9/1, ku kemi shtuar shkakun dhe termin e dhunës me bazë gjinore në zgjedhje, e cila, për mendimin tim të ngushtë, do të na jepte mundësi të kishim edhe ndonjë përkufizim në Kodin Zgjedhor të dhunës me bazë gjinore në zgjedhje.

Për sa i përket Kodit Zgjedhor, ne e kuptojmë shqetësimin e organizatave të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare që ky nuk është vendi për të realizuar të gjitha aspektet e dhunës me bazë gjinore në zgjedhje, sepse është edhe legjislacioni penal, edhe legjislacioni administrativ apo legjislacioni kundër diskriminimit, përfshirë ligjin për barazinë gjinore në shoqëri, ligjin për mosdiskriminimin e të tjera si këto. Sidoqoftë, ne mendojmë të adresojmë atë që mund të adresojë vetë Kodi Zgjedhor.

Çfarë propozojmë këtu? Gjithashtu, KQZ-ja merr masa dhe organizon programe për edukimin zgjedhor të qytetarëve, respektimin e rregullave të procesit zgjedhor, ndalimin e gjuhës së urrejtjes, gjuhës diskriminuese, dhunës me bazë gjinore në zgjedhje apo rregulla të tjera. Këtu kemi edhe këtë fjalë kyçe, që mua personalisht do të më pëlqente shumë të futej te përkufizimet se çfarë është dhuna me bazë gjinore në zgjedhje sipas kuptimeve të këtij kodi.

Për sa u përket sanksioneve, ju nuk keni një propozim të qartë, por keni propozime në nivelin politik dhe teknik. Kjo sepse mënyra si është hartuar Kodi sot për sot është e përgjithshme dhe do t'i përfshijë të gjitha, do apo nuk do. Pra, këtu përfshihet edhe dënimi me gjobë.

Siç e dini, në nenin 171 kemi këto sanksione të përgjithshme:

1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.

2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1 000 deri në 2 500 lekë. Pra, është e gjithë gjuha e Kodit që do ta përfshijë. Ka rëndësi të kuptohet që edhe këto dy raste, 20/2-i, që ne e përmendëm dhe 20/1-i, janë padyshim kundërvajtje administrative që duhet të ndëshkohen plotësisht me sanksione në këtë kod.

Akte të tjera natyrisht nuk janë objekt diskutimi sot, por unë dua të them që kjo është një fushë e gjerë, e cila përfshin kodet e sjelljes brenda partive politike, legjislacionin për partitë politike, legjislacionin e mosdiskriminimit, përfshirë ligjin “Për mbrojtjen nga mosdiskriminimi” dhe ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Neni 9 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka një përcaktim dhe në qoftë se do të elaborohet nga komisioneri, do të ishte me shumë vlerë. Gjithashtu, shumë e rëndësishme do të ishte edhe përfshirja në disa aspekte e legjislacionit penal. Ne kemi dhënë edhe vendime të ndryshme për mënyrat si do të amendohen këto, si dhe kemi bërë përpjekje për mënyrën si mund të kemi një përkufizim në Kodin Zgjedhor për dhunën me bazë gjinore në zgjedhje.

Kjo ishte paraqitja që doja të bëja duke mirëpritur çdo pyetje apo koment nga ana juaj.

Faleminderit!

**Eglantina Gjermani** – Shumë faleminderit, profesoreshë Aurela për angazhimin dhe kontributin tuaj, sidomos për ligjet që lidhen me barazinë gjinore dhe dhunën në familje!

Sugjerimet që ju dhatë ishin shumë të vlefshme, për më tepër që pjesëmarrja e grave në politikë është një risi e viteve të fundit. Çështja e dhunës ndaj grave në zgjedhje është pak e trajtuar,

kështu që mbase studimet botërore mund të na bëjnë edhe ne të mendojmë për adresimin e kësaj çështjeje dhe përfshirjen e sugjerimeve tuaja në Kodin Zgjedhor.

Ashtu siç ju dhe zonja Bulku e thatë, unë dua të ritheksoj që gjatë procesit zgjedhor gratë mund të jenë zgjedhëse, komisionere, aktiviste, kandidatë për këshillin bashkiak, për kryetare bashkie, deputete apo pozicione të tjera dhe në të gjitha këto dimensione ato mund të bien pre e dhunës në forma të ndryshme.

Kështu që, i vlerësoj shumë të gjitha sugjerimet dhe prezantimin që ju bëtë. Për më tepër, dua të theksoj në mënyrë të veçantë gjuhën e urrejtjes, që ne e ndiejmë në jetën e përditshme, në politikë, vendimmarrje, e cila padyshim që duhet adresuar, sepse ne të politikës zakonisht modelojmë edhe sjelljet e shoqërisë shqiptare. Kështu që, kemi përgjegjësi më të madhe.

Gjithashtu, vlerësoj shumë edhe sanksionet që ju prezantuat.

Fjalën e ka zonja Hysi dhe më pas kolegët për pyetje dhe diskutime.

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit, zonja Bulku dhe profesoresha Anastasi për mendimet dhe sugjerimet që sollët!

Nga ana tjetër dua të ndaj me ju një informacion për mundësitë e adresimit të rekomandimeve që UN Women-i ka sjellë. Unë lexova përbërjen e grupit të punës që ka punuar për adresimin e këtyre rekomandimeve dhe më vjen mirë që mes tyre ka shumë organizata vendase dhe ndërkombëtare. Në grupin e punës për barazinë gjinore në vendimmarrje janë edhe dy organizatat partnere të Kuvendit të Shqipërisë, OSBE-ja dhe NDI-ja.

Po e nis me këtë duke ju informuar që me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane, ku partnerë janë OSBE-ja dhe NDI-ja, Kuvendi është duke zbatuar një projekt të rëndësishëm dhe ku një komponent i rëndësishëm është edukimi ligjor i publikut në periudhën e zgjedhjeve. Në këtë kuadër, rekomandimi juaj që pjesë e edukimit të zgjedhësve edhe në çështjet gjinore duhet të jetë përparësi, mund të ishte një mundësi e mirë në kuadër edhe të projektit që mbështetet nga Agjencia Zvicerane dhe që po zbatohet nga Kuvendi i Shqipërisë me OSBE-në dhe NDI-në. Pra, ka një zë të konsiderueshëm në buxhetin e këtyre dy organizatave.

Gjithashtu, unë bie dakord me adresimet tuaja, qoftë për gjuhën e urrejtjes, qoftë për respektimin e parimit të barazisë gjinore. Ne e kemi pjesë të Kodit të Sjelljes dhe të udhëzuesit që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë, ku periudha e fushatës zgjedhore është pjesë e veprimtarisë së deputetëve ose kandidatëve për deputetë. Njëkohësisht, edhe Rregullat e *Equinet*-it, që ne i kemi të

bëra publike për çdo deputet dhe të afishuara, adresojnë me të drejtë shqetësimet ose rekomandimet që ju adresoni.

Unë ju ndoqa me vëmendje dhe në këtë periudhë ka një mundësi shumë të mirë, pasi, përveç nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, ku me të drejtë dhuna me bazë gjinore konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut dhe nënkomisionit për Barazinë Gjinore për Ndalimin Dhunës, kemi edhe disa nënkomisione të tjera, të cilat mund të kontribuojnë në këtë aspekt, siç është nënkomisioni për Çështjet e Vetëqeverisjes Vendore, me të cilin ne kemi bashkëpunim shumë të mirë dhe ndoshta Elona mund të jap më shumë informacion për bashkëpunimin e Aleancës së Grave Deputete me Aleancën e Grave në Këshillat Bashkiake, por edhe vetë Aleanca e Grave Deputete ka përparësi adresimin e këtyre çështjeve. Ashtu sikurse është shumë e drejtë edhe ajo që ju thatë, se studimet në Shqipëri për dhunën me bazë gjinore janë të pakta. Në kuadër të një bashkëpunimi rajonal që Kuvendi i Shqipërisë ka me parlamentet e tjera, për herë të parë ne po bëjmë një studim për të parë rezultatet e ligjit për barazinë gjinore, i cili shumë shpejt do të na ofrojë informacion për respektimin e kuotave dhe parimit të barazisë gjinore.

Unë kam një pyetje për zonjën Bulku dhe për zonjën Anastasi.

Këto propozime ju i sillni në dy nënkomisione përkatëse dhe ne sot po i diskutojmë. Ka një mundësi që së bashku me zonjën Bushka dhe zonjën Gjylameti, e cila është e pranishme në mbledhje, ne t'i diskutojmë edhe në komisionin *ad hoc* të Reformës Zgjedhore, pasi jemi anëtare të këtij komisioni. Ju personalisht a keni bërë ndonjë takim me këshillin politik apo bashkëdrejtuesit e Komisionit të Reformës Zgjedhore për të adresuar këto rekomandime?

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, zonja Hysi!

Do të përgjigjet zonja Anastasi apo zonja Bulku?

**Estela Bulku** – Për ne ky është takimi i parë në përgjigje të shkresës që kemi dërguar. Kështu që, nëse ky është një nga sugjerimet që ju e shikoni me vend, ne mund të vijojmë edhe me takime të tjera për t'i diskutuar këto rekomandime më në detaje. Hapi i parë që ndoqëm ishte hartimi i propozimeve në kuadër të paketës, dërgimi i shkresës nga përfaqësuesi i UN Women-it, kështu që ne mund të vijojmë edhe me hapa të tjerë siç janë edhe takimet e posaçme.

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit!

Fjala është për ju, të nderuara kolege dhe kolegë, për pyetje dhe diskutime.

Fjalën e ka kërkuar zonja Gjebrea dhe pastaj zonja Bushka.

**Elona Gjebrea** – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja nënkryetare e nënkomisionit të barazisë gjinore!

Gjithashtu, falenderoj zonjën Hysi, koleget e mia, zonjën Bulku dhe zonjën Anastasi!

Pa dyshim që është me shumë interes që ne të kemi një mbështetje me zërin e ekspertëve për sa u përket rekomandimeve, që pa dyshim e ndihmojnë dhe e fuqizojnë rolin e grave në politikë. E kemi bërë dhe do ta bëjmë gjithmonë këtë gjë. Në fakt, më vjen mirë që kemi edhe deputete që janë pjesë e Aleancës së Grave Deputete në këtë mbledhje, të cilat na dëgjojnë dhe pa dyshim që zëri ynë do të jetë një zë mbështetës edhe duke luajtur rolin tonë si ligjvënëse në Parlamentin e Shqipërisë.

Me të drejtë zonja Hysi foli për sa u përket këshillave bashkiakë, ne në fakt kemi bërë edhe një kalendar si Aleancë e Grave Deputete dhe parashikojmë që kemi shumë shpejt një mbledhje, një diskutim online, për fat të keq për shkak të situatës, me rrjetin e grave këshilltare bashkiake. Kemi nevojë, sepse nuk e kemi bërë një të tillë, pavarësisht se e kishim në axhendë dhe shpresoj që tashmë, që kemi të mbledhur dhe të rikonstituuar të gjitha nivelet bashkiake në nivel kombëtar, ne mund ta bëjmë këtë gjë. Pa dyshim që edhe roli i parlamenteve të tjera ka një zë të rëndësishëm, dhe përsëri, dhe këtu ne kemi parashikuar një mbledhje, një forum në muajin shtator me mbështetjen e OSBE-së, po pse jo ne mund të bashkojmë forcat edhe me UN Women, për të pasur një forum rajonal dhe të dëgjojmë se çfarë gratë deputete bëjnë në zonat e tyre, gjithashtu edhe për të marrë disa nisma të përbashkëta rajonale në këtë drejtim.

Ne si Nënkomisioni i Barazisë Gjinore, jam e bindur që zonja Eglantina do të thotë edhe më shumë, në takimet që kemi bërë në Malin e Zi, tashmë kemi një plan veprimi me Parlamentin për Ndjeshmërinë Gjinore, që u miratua më së fundi me vonesë edhe nga Aleanca, dhe do të kalojë edhe në Konferencën e Kryetarëve. Pra, ka një frymë shumë pozitive dhe një frymë mbështetëse, shumë më shumë se çka qenë në Parlamentin e Shqipërisë për sa u përket çështjeve me barazi gjinore, lobimit dhe përpjekjeve më tej. Besoj që ne tashmë e kemi luksin që, jo vetëm kuotën, të cilën e kemi arritur dhe që ka qenë një përpjekje nga Tina, Vasilika, Aurela (më falni po ju drejtohem me emër) të gjithë kanë qenë dëshmitarë të të gjitha punëve që kemi bërë edhe si pjesë e shoqërisë civile në atë kohë, por në një hark kohor 10-vjeçar, tashmë jemi në një situatë shumë më të pjekur dhe e kemi luksin që ne të kërkojmë më shumë. Kështu që shumë nga propozimet e zonjës Anastasi i gjej si propozime të cilat pa dyshim që do të kenë mbështetje, por do të duhet që, ashtu sikurse tha edhe zonja Hysi, me mbështetjen e kolegeve tona të nderuara në komisionin ad hoc të Reformës Zgjedhore, t'i shtyjmë më tej dhe le të jetë një mbështetje e të gjitha grave

deputete, pse jo, të kemi edhe burra, por ta fillojmë me gratë njëherë. Kështu që, ju falënderoj dhe jam e bindur që do të kemi një produkt më tej.

Faleminderit!

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjala për zonjën Bushka.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, kolege!

Përsëritje të gjithëve, edhe zonjës Bulku, edhe profesoreshë Anastasit. Unë në fakt e lexova prezantimin që e shteroi shumë qartë edhe zonja Anastasi. Në fakt më pëlqen dhe jam shumë dakord që jo vetëm si pjesë e Komisionit të Përkohshëm për Reformën Zgjedhore, por edhe si anëtarë të Kuvendit, ne gratë të paktën, pa diskutim të mbrojmë disa propozime konkrete, të cilat unë i çmoj me shumë vend, të paraqitura. Do i marr me radhë dhe do bëhem pak teknike, meqenëse po diskutojmë çështje teknike për të qenë edhe konkrete, pjesa e vendosjes së parimit të barazisë gjinore në parimet udhëheqëse të kodit, mendoj se është një aspekt që biem dakord të gjithë dhe me sa mbaj mend, mund të më korrigjojë profesoreshë Hysi, në draftin e parë të propozimeve për amendimet e Kodit Zgjedhor, që u punuan nga ekspertët përpara se të krijohej këshilli politik, ku u përfshi edhe opozita jashtëparlamentare, ky ishte një parim i sanksionuar dhe unë e konsideroj si një standard tashmë të pranuar, në bazë të vullnetit të aktorëve politikë dhe është një çështje që duhet ta konkretizojmë edhe me draftin e ri që do të bëhet.

Risia shumë e rëndësishme që unë shikoj është çështja e mekanizmave jo vetëm e parimeve, por e mekanizmave konkrete që shoh të propozuar për sa i takon faktit të mbrojtjes së vajzave dhe grave nga dhuna në zgjedhje. E kemi diskutuar shumë herë, kemi bërë përpjekje që të marrim nisma, të cilat mund ta realizojnë këtë qëllim, por e paraqitur në formën siç vjen nga ekspertët, që përfaqësohen nga profesoreshë Anastasi, mendoj që është shumë e qartë, është një punë e bërë gati. Në këtë këndvështrim, unë them që propozimet duhet t'i paraqesim tek ekspertët përkatës që po merren me komisionin, në qoftë se s'janë bërë, sepse është një nevojë reale në shoqërinë tonë, dhe për sa kohë kemi një nismë që, me sa kuptoj është edhe e konsultuar me grupet e interesit, i vjen në ndihmë pikërisht këtij procesi.

Pjesa e barazisë gjinore në organet e administrimit zgjedhor, mendoj se është një qëllim në vetvete i secilës prej nesh, jo vetëm e grave, por edhe e burrave në Kuvend, për sa kohë në prioritetet e reformës zgjedhore ka qenë jo vetëm depolitizimi i administratës, por edhe ruajtja e balancës midis burrave dhe grave nëpër këto komisione. Tashmë ne të gjithë e dimë që formula e



Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të ndryshojë, për sa kohë ne po adresojmë dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare për përmirësimet e mekanizmave në procesin zgjedhor, por edhe sa i takon çështjeve që lidhen me barazinë gjinore, kështu që e shikoj të logjikshme, për sa kohë ne garantojmë kuotën gjinore në zgjedhje, që i njëjti nivel duhet të garantohet edhe në organet që merren me administrimin apo me monitorimin zgjedhor. Do të mbetet për t'u parë sesi do të dalë në fund formula e dakordësuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe kriteret përkatëse për organet e administrimit zgjedhore në nivelet më poshtë, në mënyrë që edhe kriteri i barazisë gjinore të jetë atje i garantuar.

Mendoj se këto janë risi të arritshme dhe që duhet të gjejnë mbështetjen tonë dhe ju falënderoj për punën e kryer!

Ndërkohë unë kam disa komente, se pyetjet besoj janë të qarta, por mund edhe t'i diskutojmë së bashku në lidhje me dy propozime që shikoj në materialin e paraqitur, në lidhje me kuotën gjinore që propozohet të unifikohet si në zgjedhjet për Kuvendin, ashtu dhe në zgjedhjet për pushtetin vendor. Shqetësimi këtu është ky: përveç vullnetit politik sa i takon përqindjes përkatëse të kuotës gjinore në listat e kandidatëve, gjithmonë këto risi duhet të propozohen në bazë të analizave të thella, të plota në çdo realitet. Domethënë, Tirana nuk është njësoj si Elbasani e kështu me radhë, pra çdo rreth, çdo bashki ka ato specifikat e veta. Jam shumë dakord që të vazhdohet lufta për rritjen e kuotës gjinore, por në qoftë se ne do t'i unifikojmë mekanizmat, nuk duhet të bëjmë hapa mbrapa, çka do të thotë 50% të kuotës, që tashmë është e arritur në pushtetin vendor, ne nuk mund ta cenojmë, pra duhet ta ruajmë atë si një standard. Kur flasim për unifikim, duhet ta llogarisim në bazë të analizave të sakta, arrijmë dot të njëjtën vlerë edhe në zgjedhjet për Kuvendin? Në qoftë se jo, unifikimi si propozim mund të na rrezikojë atë që tashmë e kemi arritur në pushtetin lokal. Pra, kjo kërkon një analizë të thellë, pra nuk mendoj se është thjesht çështje vullneti politik, por është çështje më e gjerë edhe e analizave më konkrete.

Pavarësisht dëshirës të të gjithave ne, besoj që arritja e barazisë së plotë si në hyrjen në procesin zgjedhor, si në lista, si në dalje, mbas paraqitjes së rezultateve finale të votimit, të arrihet. Dhe tjetra, është bërë një propozim që të arrihet kuota gjinore, barazia gjinore edhe sa i takon zgjedhjes së kryetarëve të bashkive. Ato janë gara të hapura, janë gara direkte për kandidatët për kryetar bashkie, dhe unë shikoj që, pavarësisht se profesororeshë Aurela e shpjegoi shumë mirë, ne nuk do të merremi me çdo propozim, se kërkon ndërhyrje në legjislacionet e tyre, por vetëm me ato që prekin Kodin Zgjedhor. Propozohet që të zgjidhen kryetarët nga këshillat bashkiakë. Këtu

duhet të jemi të ndërgjegjshëm që kjo ndryshon në një farë mënyre formulën e zgjedhjes së parashikuar tashmë në kod. Është momenti për ta menduar, për ta diskutuar, por duhet të jemi, them unë, me këmbët në tokë për të kuptuar që jo të gjitha gjërat mund t'i arrijmë menjëherë dhe prandaj duhet të prioritarizojmë edhe nevojat, por edhe kërkesat.

Pastaj për çështjet e drejta që shtrohen, që duhet të ketë barazi gjinore edhe në kryesimin e komisioneve të Kuvendit apo në administrimin e njësive vendore, flasim për administratorët jo ata që zgjidhen nga populli, kryetarët e bashkisë apo kryetarët, po flasim për administratorë e njësive brenda bashkive. Këto janë çështje të cilat, në fakt i takojnë ligjeve të tjera dhe zonja Hysi ju shpjegoi që ne tashme kemi një projekt për sjelljen e Parlamenti, në kushtet e një Parlamenti me ndjeshmëri gjinore dhe në Kodin e Sjelljes kemi vënë parime që na ndihmojmë të ecim në këtë rrugë, kështu që për Kuvendin e shikoj më të thjeshtë diskutimin, domethënë është sfidë, por është diçka që i ka nisur shinat e veta. Sa u takon administratorëve lokalë, jam shumë dakord që të ruhet edhe atje barazia gjinore. Duhet parë dhe të studiohen ligjet e tjera që kanë të bëjnë me rregullimet për zgjedhjen apo emërimin e administratorëve lokalë, qoftë në ligjin për njësitë e vetëqeverisjes apo në ndonjë legjislacion tjetër, që mund t'i prekë këto çështje.

Është shumë interesant materiali që keni përgatitur. E shoh që përtej atyre 10 faqeve që na keni prezantuar ka studime të tëra dhe konsultime që ju keni kryer dhe ju falënderoj dhe përgëzoj për këtë punë, por duke qenë se çështjet që keni ngritur janë të gjitha reale dhe na shqetësojnë të gjithëve, ju inkurajoj ta vijoni këtë punë, në mënyrë që të bëjmë një prioritizim të atyre gjërave që janë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për t'u ndjekur.

Ne sot jemi në Kuvend, nesër ndoshta nuk do të jemi të gjitha, ama Aleanca e Grave Deputete do të vazhdojë, komisionet dhe nënkomisionet do të vazhdojnë dhe është mirë që në një plan pune, apo në një strategji që ne tashmë e kemi miratuar, të përfshijmë edhe gjëra që ndahen me faza, plane afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata dhe, sipas mundësive, të luftohet për të gjitha, por duke vënë prioritetet, sepse kështu do ta bëjmë edhe më të prekshme dhe më të arritshme punën dhe qëllimet që i kemi vënë vetes.

Faleminderit!

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, zonja Bushka, për vlerësimet dhe sugjerimet shumë konkrete!

A ka pyetje, ose komente nga dikush tjetër?

Po, zonja Gjylameti, fjala për ju.

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, Eglantina, faleminderit edhe Vasilikës për mundësinë që na keni dhënë për të dëgjuar nga afër qoftë pjesën e studimit të mundësuar nga profesoresha Anastasi bashkë me mbështetjen e UN-it, por edhe për gjetjet në lidhje me këtë studim, sepse besoj se janë shumë të vlefshme dhe vijnë në një kohë shumë të rëndësishme, po rishikojmë dhe një pjesë të mirë të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër vlerësoj, sikundër e vlerësoj edhe koleget e mia pak më parë, që ndarja në prioritete dhe prioritetet, që sipas Kodit mund të realizohen, ato afatgjata, afatshkurtra, apo ato që mund të cenonjë qoftë dhe rezultatet e arritura, është shumë e rëndësishme në këtë moment. Ne jemi në një fazë që në Komisionin e Reformës Zgjedhore, përtej draftit të parë në linja të përgjithshme të dakordësuar, qoftë në opozitën parlamentare, qoftë atë jashtëparlamentare, sikundër e keni ndjekur, ka një moment ku Këshilli Politik do të duhet të dorëzojë draftin përfundimtar, në bazë të adresimit të rekomandimeve të ODIHR-it, por mbi të gjitha të dakordësisë politike, që në rastin konkret doli të jetë shumë herë më e rëndësishme sesa vetë rekomandimet dhe synimi që ka pasur Komisioni i Reformës Zgjedhore, duke pritur këto ditë draftin përfundimtar dhe duke shpresuar se nuk do të kemi një devijim, apo anashkalim nga ato rezultate të arritura deri sot. Klotilda e tha pak më parë që një pjesë të shqetësimeve që keni ngritur janë të adresuara në draftin e Kodit Zgjedhor, por duke shpresuar që nuk do të kemi kthim pas, por përmirësime të draftit, ne do të jemi të hapura në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të Reformës Zgjedhore, duke shpresuar në mirëkuptimin e të gjithë kolegëve dhe të atyre që zgjodhën të ishin jashtë parlamentit, që ndryshimet që do të bëhen të jenë për realizimin sa më të mirë si të përfaqësimit të grave në politikë, ashtu edhe në të gjithë procesin zgjedhor, pra në të gjithë administratën zgjedhore.

Unë përsëri e kam shqetësimin se nganjëherë tendenca për të kërkuar shpeshherë gjëra të arritshme, por me mungesë vullneti nga të gjitha palët, bëhet pengesë për të pasur promovimin e hapave të vegjël, që janë arritur. Shpeshherë synojmë për shumë, por ndonjëherë nuk realizohen. Ndaj e thashë në krye të herës, që edhe opozita jashtëparlamentare të ketë mirëkuptim për ato ndryshime që do të bëhen në Komisionin e Reformës Zgjedhore, duke shpresuar që edhe drafti, që do të na vijë, të jetë i përmirësuar por jo i përkeqësuar nga gurët e themelit që janë vendosur.

Shpresoj shumë që edhe në ligjet e tjera që do të pasojnë, apo shoqërojnë të gjithë paketën e reformës zgjedhore (qoftë në pjesën e financimit të partive politike, qoftë dhe në ligjin e referendumeve) dhe në të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me Komisionin e Ligjeve, pra rishikimin e

Kodit të Procedurës Penale (pa dashur t'i rendis të gjitha) të kemi mundësinë të përmirësojmë akoma më shumë atë që deri sot kemi arritur!

E thashë pak më parë, shpresojmë shumë që edhe mbledhja e fundit e Këshillit Politik të jetë një përmirësim i asaj që kemi arritur! Besoj shumë që do ta gjejmë mirëkuptimin dhe në fund dialogu do të prevalojë mbi interesa shumë të vogla partiake të secilës palë!

Faleminderit shumë për prezantimin, për sugjerimet dhe punën e bërë!

**Eglantina Gjermeni** - Shumë faleminderit, zonja Gjylameti!

Në fakt, ne e vlerësojmë shumë angazhimin dhe kontributin tuaj, por edhe të zonjës Hysi, që jeni pjesë e Komisionit për Reformën Zgjedhore! Pa dyshim që do të kërkojmë mbështetjen tuaj në momentin që ne si nënkomisione do të biem dakord për të përcjellë këtë letër të përbashkët për sugjerime ndaj Këshillit Politik për reformën zgjedhore.

Është bërë një pyetje nga zonja Dhima dhe zonja Hysi do t'i përgjigjet.

**Vasilika Hysi** – Kolegia Antoneta Dhima ka bërë një pyetje nëse këto çështje janë të shqyrtuara në Komisionin e Reformës Zgjedhore, apo jo.

E nderuar kolege, në fakt, kjo letër i ka shkuar edhe dy bashkëkryetarëve, sikurse na ka ardhur edhe neve. Para ngritjes së Këshillit Politik ne si Komision për Reformën Zgjedhore, kemi shqyrtuar një paketë propozimesh të hartuar nga ekspertët e ODIHR-it dhe ekspertët që ka komisioni. Paketa që lidhet me barazinë gjinore ka pasur një diskutim, e tha më të drejtë dhe kolegia Bushka, nuk ka qenë keq, ka qenë goxha mirë, referonte, ose një sërë sugjerimesh, që kanë ardhur nga grupi i punës për barazinë gjinore, por nuk e dimë se si është vijueshmëria në Këshillin Politik, që me të drejtë e tha edhe kolegia Gjylameti. Do të doja të theksoja vetëm një gjë, nëse të dyja nënkomisionet do të bien dakord, një pjesë të këtyre rekomandimeve, se tashmë bashkëkryetarët e kanë letrën, ne do t'i përcjellim edhe në emrin e dy nënkomisioneve.

Analiza që bëri zonja Bushka është ndihmuese, në kuptimin që ne të dimë se çfarë mund të adresohet për momentin në ndryshimet e Kodin Zgjedhor dhe për të cilat mund të këtë një vullnet politik nga të dyja palët, sikurse duhet të jemi pak të kujdesshëm te propozimet e karakterit teknik, që janë bërë lidhur me përbërjen gjinore në KZAZ-të dhe në KQV-të. E them këtë se nëse ne do të pranojmë këto dy sugjerime, që janë sjellë te neni 29, ku flitet për përbërjen e KZAZ-së dhe te neni 36, mund të bëjmë hapa mbrapa. Aktualisht në zgjedhjet e fundit ne kemi pasur një përbërje të komisioneve 50 me 50, pra nuk kemi pasur dy anëtarë të gjinisë më pak të përfaqësuar, por kemi pasur barabar burra dhe gra, madje në shumë komisione kemi pasur më shumë gra sesa burra. Në

këtë kuadër do të vlerësoja shumë kontributin e profesoreshë Anastasit, me qëllim që 1, 2, ose 3 rekomandime, ose propozime të bëra, të shihen pak me vëmendje dhe të mos bëjmë pa dashje kthim pas.

Unë kam edhe një pyetje lidhur me propozimet që keni bërë për Kodin Penal. Komisioni i Ligjeve do të marrë në shqyrtim ndryshimet në Kodin Penal, ndryshimet që lidhen me ligjin “Për financimin e partive politike” dhe në disa ligje të tjera, kurse Komisioni për Reformën Zgjedhore do të marrë ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Kjo paketë propozimesh a ka vajtur te Kryetari i Kuvendit dhe te kryetari i Komisionit të Ligjeve, me qëllim që të jenë bërë në kohë? Pse e them këtë? Shumë shpejt ne do të marrim propozimet e Këshillit Politik të kthyer në gjuhën teknike nga ekspertët dhe do të fillojë shqyrtimi në komision dhe brenda datës 30 korrik mendohet që të gjitha këto ndryshime do të miratohen. Në këtë kuadër ka shumë nevojë që ju t’i prezantoni, që të kemi një konsultim publik dhe të mos kemi më pas diskutime për të thënë që nuk jemi dëgjuar ose janë marrë në konsideratë.

Procedura parlamentare ka disa afate që i kërkon edhe në rastin konkret të nismës që kemi propozuar, të cilat i depozituat në kohë dhe ne po i paraprijmë nëpërmjet dëgjimit që po bëjmë këtu dhe besoj se do të ketë një vullnet shumë të mirë për ta përcjellë edhe në Komisionin e Reformës Zgjedhore. Pra, a keni diskutime, ose amendamente të tjera në paketën e ligjeve që priten të ndryshojnë?

**Aurela Anastasi** – A mund ta marr unë fjalën?

**Eglantina Gjermani** – Patjetër.

**Aurela Anastasi** – Faleminderit, zonja Gjermani!

Unë doja të thosha që paketa e propozimeve vjen nga shumë aktorë dhe propozimet ishin të ndryshme. Është e konsultuar, sikurse me të drejtë ju e vutë re, nga shumë organizata kombëtare dhe ndërkombëtare. Me UNO-n ne kemi përgatitur edhe një raport të legjislacionit shqiptar. Në këtë raport, krahas analizës, tentohet të jepen edhe mendime se si mund të evoluojë dhe ndryshojë legjislacioni shqiptar për të adresuar në të gjitha aspektet çështjen e parandalimit dhe të ndalimit të dhunës ndaj grave në zgjedhje, por duhet të them se, për sa di unë, zonja Stela mund ta sqarojë më mirë, ky është thjesht një raport eksperti dhe unë vetë jam konsultuar vetëm me kolegë dhe nuk ka një proces konsultimi. Për sa e njoh unë situatën deri tani është fillestare, pra thjesht një propozim eksperti që duhet të konsultohet dhe të prezantohet. Unë këtë mund të jepja si përgjigje.

Faleminderit!

**Eglantina Gjermeni**– Zonja Bulku, keni diçka për të thënë?

**Estela Bulku**– Po, faleminderit!

Ashtu siç tha edhe profesoreshë Aurela, paketa e propozimeve, e paraqitur pranë Kuvendit, përfaqëson mendimet dhe kontributet e shumë aktorëve. Ato që u punuan nga “UN WOMEN”, me ndihmën e profesoreshë Aurelës, ishin propozime konkrete lidhur me fenomenin e dhunës ndaj grave në zgjedhje e në politikë.

Meqenëse ishte në diskutim Kodi Zgjedhor, ne e përqendruam të gjithë vëmendjen te propozimet konkrete, që mund të paraqiten në kuadër të reformës zgjedhore, në kuadër të Kodit Zgjedhor.

Sigurisht, duke qenë një fenomen kompleks, ne filluam punën për të bërë analizën në nivel eksperti, për të parë dhe aspekte të tjera të legjislacionit shqiptar, që mund të adresohen përpos Kodit Zgjedhor, për të adresuar dhe parandaluar këtë fenomen.

Kësisoj, ishte vetëm hapi i parë, të cilin ne mund ta vijojmë me konsultime dhe me propozime konkrete edhe për ligjet e tjera. Thjesht u detyruam që të dorëzonim në paketë vetëm ato që kanë të bëjnë me hapësirën që ofron Kodi Zgjedhor.

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, zonja Bulku!

Nga kolegët, a ka kush diçka për të thënë?

Zoti Ulqini, fjala për ju! Pastaj zonja Spahiu.

**Musa Ulqini** – Në punën që kam bërë, kam qenë pro çdo gjëje që stimulon, nxit, garanton pjesëmarrjen e zonjave të nderuara në të dyja nivelet e pushtetit: pushtetit vendor dhe në pushtetit legjislativ, por mendoj se disa propozime, ose ndonjë propozim që u bë këtu bie ndesh me atë që është thelbi i republikës sonë. Ne jemi republikë parlamentare, ku vota e qytetarëve është në themel, në thelb të funksionimit të republikës sonë. Pa bërë diskutime teorike mes raportit të demokracisë përfaqësuese dhe asaj të drejtpërdrejtë, unë shprehem kundër që, në emër të idesë që të kemi sa më shumë zonja në krye të bashkive të republikës, në 61 bashkitë, të cenojmë parimin e zgjedhjes së kryetarëve të bashkive, që e kemi drejtpërsëdrejti nga vota e qytetarëve, sepse sot, në Republikën e Shqipërisë, deputetë nuk i zgjedhim drejtpërsëdrejti, por janë nga listat e partive. Këshilltarët, që janë në parlamentet vendore, ne i zgjedhim nga listat e partive. Mendoj se është një gjë shumë e mirë që kryetarët i zgjedhim drejtpërsëdrejti, me votën e qytetarëve. Nuk duhet ta cenojmë këtë parim, sepse ka një ndjeshmëri të madhe në publikun shqiptar, që qytetarët të respektohen, duke i pyetur ata përmes votës së drejtpërdrejtë. Referendumet janë një mjet

demokratik. Nuk e kam fjalën për Zvicrën, sepse edhe në Shqipëri kjo e drejtë ekziston si e drejtë kushtetuese e qytetarëve, por jam kundër përpjekjes që, për të shtuar praninë e grave në pushtetin vendor, të përdoret ky mekanizëm, pra të heqim zgjedhjen e kryetarëve nga vota e drejtpërdrejtë e qytetarëve.

E them këtë, sepse problemet lokale, problemet vendore janë shumë konkrete dhe lidhen drejtpërsëdrejti me qytetarët, dhe ata që drejtojnë bashkitë duhet të kenë një raport të drejtpërdrejtë me hallet e qytetarëve. Ky raport i drejtpërdrejtë është i tillë vetëm atëherë kur ata zgjidhen drejtpërsëdrejti nga qytetarët, dhe nuk është kjo rruga, nuk është ky mekanizmi, nuk është ky instrumenti për të shtuar praninë e grave në pushtetin vendor.

Ju falënderoj shumë për gjithçka që u zhvillua këtu dhe unë, i pranishëm këtu si anëtar i Nënkomisionit të Barazisë Gjinore, u përpoqa që, mbi bazën e një përvoje të gjatë në parlamentin e Shqipërisë, ku janë provuar të gjitha llojet e sistemeve, të jap një mendim modest në lidhje me çështjet që po diskutojmë.

Faleminderit edhe një herë!

**Eglantina Gjermeni** – Faleminderit, zoti Ulqini!

E vlerësoj kontributin dhe angazhimin tuaj të përhershëm në mbështetje të çështjeve të barazisë gjinore. Besoj se kur ka ardhur sugjerimi nga “UN WOMEN”, për shtimin e numrit të grave kandidate për kryetare bashkie nuk ka cenuar parimin për zgjedhjen e drejtpërdrejtë, por që kryetarët e partive, kryesitë e partive të kenë në listën e kandidatëve për kryetarë bashkie zonja dhe zotërinj, gra dhe burra, sepse kemi parë se zakonisht janë burra, ose në shumicën e rasteve janë më shumë burra kandidatë se sa gra. Për këtë është fjala. Nuk besoj se është fjala të ndryshojmë atë parim. Thjesht për të qenë të saktë.

Faleminderit!

Zonja Spahiu, fjala për ju!

**Musa Ulqini** – Kryetare, më falni! Unë tërhiqem dhe kërkoj ndjesë, por dëgjova sikur propozimi ishte që kryetarët e bashkive të mos zgjidhen drejtpërsëdrejti nga vota e qytetarëve, por të zgjidhen nga këshillat, siç e ka, fjala vjen, Mali i Zi dhe vende të tjera.

Dëgjova këtë propozim. Ju kërkoj ndjesë nëse e kam dëgjuar gabim dhe tërhiqem, por në qoftë se ky propozim është, unë jam kundër. Kaq.

Faleminderit!

**Eglantina Gjermeni** – E vlerësoj shumë.

Zonja Spahiu, fjala për ju!

**Klodiana Spahiu**– Faleminderit, Tina!

Meqenëse po afron koha dhe janë minutat e fundit, unë do të doja t’i bija shkurt.

Falënderime për profesoreshën dhe për Entelën, si dhe për të gjithë prezantimin!  
Falënderime për “UN WOMEN”!

Shqetësimi im i vetëm është që më shumë të ndaj një opinion me ju se sa të bëj një pyetje. Ditët e fundit është diskutuar shpeshherë nga opozita parlamentare në lidhje me sistemin zgjedhor. Shqetësimi im i vetëm është që, në këta dhjetë vjet, në fakt është bërë një përpjekje maksimale për angazhimin e grave e vajzave në politikë. Ne nuk mund ta mohojmë faktin se, një numër shumë i madh i deputeteve janë të përfshira sot dhe kanë një vend në Kuvendin e Shqipërisë, pikërisht për shkak edhe të këtij sistemi aktual që kemi.

Unë nuk kam asgjë, duket sikur sistemi me lista të hapura është më transparent. Në fakt, personalisht mendoj se secila nga ne do të druhej të kishte një përballje. Pak më parë, kolegu Musai, në një keqkuptim, mendoi se do të kandidonte gruaja, por jo me garë. Ne e dimë shumë mirë se kemi më pak kryebashkiake gra, sepse gratë e kanë shumë të vështirë ta fitojnë një betejë, ta fitojnë një garë. Nuk është aq e thjeshtë.

Prandaj, unë do të shpresoja shumë që ne të kemi një mirëkuptim, sepse shoh se ajo nismë e tyre është përkrahur edhe nga shoqëria civile. Mendoj se në këta dhjetë vjet, ne jemi bërë më shumë në parlament, jemi bërë më shumë në këshillat bashkiakë, pikërisht pse janë vlerësuar gra e vajza, dhe u është bërë ftesa për t’u angazhuar në politikë. Përballja në fushatat zgjedhore individuale, besoj se është një çështje ende e vështirë.

Megjithatë, këtë doja ta ndaja si opinion me të gjitha mikeshat që janë aty, me Musain, që e kemi përfaqësues, sepse duhet ta shprehim edhe ne opinionin tonë. Nuk është një opinion nëpërmjet të cilit po kërkojmë të mbrojmë forcën tonë politike, por për të mbrojtur veten, për të mbrojtur përfshirjen e sa më shumë grave dhe vajzave në politikë dhe në vendimmarrje.

Faleminderit, Tina!

**Eglantina Gjermani** – Faleminderit, zonja Spahiu, si për vlerësimin, ashtu edhe për opinionin tënd kaq të rëndësishëm! Unë doja ta theksoja arritjen e një numri të konsiderueshëm, i një pjesëmarrjeje prej gati 30% të grave në parlament, në këshillat bashkiake. Në fakt është vendosur 50%, pavarësisht se nuk është arritur në masën e plotë. Është një numër i madh grash të



zgjedhura, të votuara, por edhe të emëruara në pozicione vendimmarrëse. Ky është një tregues për zhvillimin e demokracisë, për emancipimin e shoqërisë, por edhe arritje e punës së shumë aktorëve.

Parlamenti ka pjesën e vet, qeveria të vetën, organizatat ndërkombëtare, shoqëria civile, emancipimi i shoqërisë shqiptarë, të gjitha bashkë. Ndërkohë, adresimi i dhunës, që po trajtojmë sot, i dhunës ndaj grave në zgjedhje, në proceset zgjedhore dhe në politikë, është një fenomen, që realisht na prek të gjithëve, pavarësisht se pak flitet për këtë.

Prandaj, unë dua ta vlerësoj e ta theksoj edhe një herë, që prezantimi që bëri profesoreshë Aurela, me sugjerime konkrete, për të t'iu deleguar Këshillit Politik në kuadrin e rishikimit të Kodit Zgjedhor, besoj se gjeti mbështetjen e kolegeve dhe kolegëve të të dy nënkomisioneve, të Aleancës së Grave Deputete. Mendoj se me ndihmën e profesoreshë Aurelës, ne do të hartojmë një letër të përbashkët e me sugjerime konkrete për Këshillin Politik, duke referuar ato sugjerime për përmirësimin apo për përfshirjen e perspektivës gjinore në këtë kod, ato që kemi afatshkurtra. Ndërkohë, do t'i ndajmë së bashku, edhe sipas sugjerimit të zonjës Bushka, në afatmesme e afatgjata.

Besoj se me prezantimin që u bë sot nga profesoresha ramë dakord pothuajse të gjitha ose të gjithë, për t'i adresuar një letër të përbashkët Këshillit Politik, duke dhënë edhe mbështetjen tonë, që të merren në konsideratë në lidhje me rishikimin e Kodit Zgjedhor.

A jemi të gjithë dakord? Ka ndokush diçka për të thënë? Pra, jemi dakord të gjithë. Do të bëjmë një letër të përbashkët. Duhet ta votojmë? Jo. Nuk ka nevojë.

Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen!

Doja të falënderoja në mënyrë të veçantë zonjën Bulku, profesoreshë Aurelën për prezantimin e për të gjithë punën e bërë, zonjën Agolli, të tria përfaqësueset që ishin me ne nga "UN WOMEN", për angazhimin, kontributin e vazhdueshëm, si dhe për ndihmën që do të na jepni, derisa ta përmbyllim së bashku këtë proces.

Pa dyshim, duhen falënderuar të gjitha koleget e kolegët, që ishin pjesë e këtij diskutimi, për kontributin dhe angazhimin e tyre! Faleminderit të gjithëve! Pa dyshim, falënderime për zonjën Hysi, nënkryetaren e Kuvendit, e cila është gjithmonë pararojë dhe mbështetëse në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut e të barazisë gjinore!

Ju faleminderit të gjithëve!

Do të jemi në kontakt sërish lidhur me mbledhjen e ardhshme!

Faleminderit! Ditën e mirë!

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**